



Funded by
the European Union

Themelimi i Njesisë për Ekspertizë: mësimet nga e kaluara për një fond par excellence



—
Maj 2022

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

Themelimi i Njesisë për Ekspertizë: mësimet nga e kaluara për një fond par excellence

Maj 2022

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

— Përmbajtja

Hyrje	3
Vendimi për themelimin e "Njesisë për Ekspertizë"	4
"Fondi për Kuadro" 2009-2015	5
Praktikat e ngjashme në vendet tjera	7
Përfundime dhe rekomandime	8



**Funded by
the European Union**

KOSOVO 2.0

gap INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE

Hyrje

Tranzicioni i pasluftës që po kalonte Kosova bëri që vendi të përballej me një mungesë të madhe të personelit të kualifikuar në shërbimin e saj civil. Si rrjedhojë, një numër i programeve dhe skemave financiare nisën së zbatuari me qëllim të tërheqjes së kuadrit profesional dhe ekspertëve për të përmirësuar shërbimin civil, të tilla si: Programi për Lehtësinë e Ngritjes së Kapaciteteve (Capacity Building Facility, CBF), Programi për Ngritjen e Kapaciteteve për Integrim Evropian (Capacity Building for European Integration, CBEI), apo skema që parashihnin shtesa në paga, si dhe projekte të tjera për ngritje të kapaciteteve të bazuara në mënyra ad hoc.¹

Nga të gjitha këto programe të sipërpërmendura, vetëm CBF mundësonte reforma në të gjithë shërbimin civil, meqë mbulonte një shumëllojshmëri të gjerë fushash. Programet e tjera sikurse CBEI ishte fokusuar vetëm tek ato reforma që mundësojnë ngritjen e kapaciteteve të kërkuara në kuadër të integritit evropian. Në anën tjetër, programet e shtesave të pagave kanë qenë më të vështira për t'u monitoruar dhe efikasiteti i tyre afatgjatë nuk ka qenë edhe mjaft i qartë, ndërsa programet ad hoc të mbështetura në donacione të organizatave ndërkombëtare nuk kanë garantuar reforma gjithëpërfshirëse.²

Duke marrë parasysh këto iniciativa, Instituti GAP ka analizuar propozimet e politikave të mëparshme dhe programeve ekzistuese që kishin si synim zhvillimin e kapaciteteve në Kosovë. Në vitin 2008, pas intervistave me shumë akterë të ndryshëm si profesionistë, përfaqësues të donatorëve, pjesëtarë të shoqërisë civile, si dhe zyrtarë publikë, Instituti GAP propozoi krijimin e "Fondit të Trurit",³ i cili do të kishte për qëllim të tërheqë dhe caktojë profesionistë në pozita menaxheriale me rëndësi strategjike për vendin, gjë që do të ndikonte pozitivisht në rritjen e efikasitetit dhe suksesit të këtyre strategjive dhe reformave, si dhe do të rriste nivelin e profesionalizmit dhe aftësive së përgjithshme të shërbyesve civilë.

Me gjithë fillimin e mirë, "Fondi i Trurit", i cili zyrtarisht u emërtua si "Fondi për Kuadro", do të shndërrohej gradualisht nga një fond për tërheqjen e kuadrove deficitare, në një fond për shtesa për pozita menaxheriale. Meqë kjo nismë kishte devijuar nga qëllimi fillestar, Instituti GAP kishte propozuar shuarjen e "Fondit për Kuadro" me qëllim të mos abuzimit me paranë publike.⁴ Në janar të vitit 2022, Qeveria e Kosovës ka ringjallur idenë e krijimit të një fondi të veçantë ("Fondi i Ekselencës") për tërheqjen e ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar në ofrimin e ekspertizës për institucionet publike. Ky raport ofron më shumë detaje mbi nismën e re të qeverisë, duke krahasuar atë me praktikën e kaluar gjatë vjeçare të "Fondit për Kuadro", si dhe ofron disa shembuj të praktikave të ngjashme të shteteve tjera. Duke kujtuar mësimet nga dështimet e iniciativave të kaluara, raporti ofron edhe disa rekomandime mbi zhvillimin e "Fondit të Ekselencës".

1 Instituti GAP. Brain Fund Program. (dokument i papublikuar). 2008.

2 Ibid.

3 Zyra e Kryeministrit. Vendimi nr.01/48, i datës 24 dhjetor 2008. Burimi: <http://bit.ly/1vbbkFC>

4 Instituti GAP. Fondi për Kuadro: Program për Financimin e Pozitave Deficitare apo Menaxheriale? Shtator 2015. Burimi: <https://bit.ly/3K06p8o>

Vendimi për themelimin e “Njesisë për Ekspertizë”

Një ndër sfidat më të mëdha të sektorit publik mbetet mbajtja e stafit të specializuar në fusha të ndryshme në shërbimin civil, meqenëse për një kohë është vërejtur largimi i tyre nga ky sektor. Si rrjedhojë, një sfidë e identifikuar në sektorin publik është mungesa e kapaciteteve të specializuara në fushat përkatëse.

Lidhur me këto sfida, Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, në një takim konsultativ me donatorë, të mbajtur me 26 tetor 2021, tregoi se janë në përgatitje të një “Fondi të Ekselencës” i cili ka për qëllim të ndihmojë qeverinë të arrijë objektivat prioritare duke mbështetur iniciativat zhvillimore dhe të përshpejtojë reformën në sektorin publik.⁵ Rreth dy muaj më vonë, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar të vitit 2022, Qeveria e Kosovës mori vendim për themelimin e “Njesisë për Ekspertizë” e cila do të jetë në kuadër të Sekretariatit Koordinues të Qeverisë në Zyrën e Kryeministrit, dhe ka si qëllim mbështetjen e institucioneve në fushat specifike dhe deficitare, duke angazhuar ekspertët vendor dhe ndërkombëtar.⁶ Në bazë të këtij vendimi “Njësia për Ekspertizë” do të ketë për detyrë të:

- identifikojë nevojat e institucioneve publike për ekspertizë dhe tregun e ekspertëve brenda dhe jashtë vendit;
- administrojë procesin e angazhimit të ekspertëve me qëllim të përmbushjes së kërkesës për ekspertizë përmes ofertës së tregut; si dhe
- të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë tjera, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe nga menaxhmenti i Zyrës së Kryeministrit.

Qeveria ka arsyetuar themelimin e kësaj njësie si rezultat i ngecjeve me të cilat është përballur në zbatimin e politikave për shkak të mungesës së kapaciteteve të specializuara në fushat përkatëse. Për më shumë, pritjet e qeverisë janë që përmes angazhimit të këtyre ekspertëve të përmirësohet hartimi dhe zbatimi i politikave, planifikimi dhe zbatimi i projekteve, si dhe të ofrohen këshilla për ekzekutivin. Në anën tjetër, theks të veçantë në këtë vendim ka edhe ideja e angazhimit të kuadrove të specializuara nga diaspora, si dhe thellimi i bashkëpunimit me ta.

Në një hulumtim preliminar të realizuar nga Zyra e Kryeministrit, është identifikuar se nevoja e institucioneve të qeverisë për ekspertizë është 45,000 ditë pune. Ndërsa, me qëllim të funksionalizimit të kësaj njësie, qeveria është zotuar që në pajtim me Ligjin e Buxhetit për vitin 2022, të ndajë mjete financiare në vlerë deri një milion euro.⁷

Sidoqoftë, në këtë vendim nuk definohet qartë se cilat janë ato institucione tek të cilat është shfaqur nevoja për 45,000 ditë pune ekspertizë dhe sa ekspertë parashihet të angazhohen. Në anën tjetër, duke marrë parasysh nevojën e madhe për ekspertizë dhe domosdoshmërinë e mbulimit të sa mëparshëm të deficitit të kuadrove, fondi prej një milion euro i paraparë sipas vendimit nr.04/54 të datës 12 janar 2022, nuk është i mjaftueshëm. Lidhur me këtë, Kryeministri Kurti, në një takim me donatorë në tetor të vitit të kaluar, diskutoi për mbështetje të mundshme financiare nga donatorët, ose përmes asistencës teknike.⁸ Qeveria shpreson se fondit prej një milion euro, donatorët do t'i bashkangjiten edhe me 20 milionë euro shtesë. Deri më tani, qeveria dhe donatorët nuk kanë treguar nëse organizatat donatore do kontribuojnë në “Fondin e Ekselencës”.

5 Zyra e Kryeministrit (2021), Kryeministri Kurti: Fondi i Ekselencës do të mbështesë iniciativat tona të shumta zhvillimore. Burimi: <https://bit.ly/3Dhm15z>

6 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2022), Vendimi nr. 04/54. Burimi: <https://bit.ly/3JM0F2F>

7 Ibid.

8 Zyra e Kryeministrit (2021), Kryeministri Kurti: Fondi i Ekselencës do të mbështesë iniciativat tona të shumta zhvillimore. Burimi: <https://bit.ly/3Dhm15z>

"Fondi për Kuadro" 2009-2015

Qeveria e Kosovës kishte realizuar një praktikë të ngjashme gjatë periudhës 2009-2015, ku pas propozimit të Institutit GAP për themelimin e një fondi special buxhetor për tërheqjen e ekspertëve të fushave deficitare në shërbimin publik, kishte themeluar "Fondin e Trurit".⁹ Marrë parasysh pagat e vogla në sektorin publik, institucionet qeveritare e kishin të vështirë të tërhiqnin ekspertët në shërbimin civil dhe në pozitat e tjera me rëndësi strategjike për vendin.

Foto 1. Lajmi i publikuar në GAP Monitor, maj 2009, pas vendimit të Qeverisë për aprovimin e "Fondit për Kuadro"



Prandaj, përmes këtij fondi i cili më vonë mori emrin si "Fondi për Kuadro", do të krijoheshin disa pozita të reja për specialistët e nivelit të lartë të cilët do të paguheshin nga 800 deri në 1,800 euro në muaj, varësisht nga pozita.¹⁰ Fillimisht, u krijuan tetë pozita të reja për të cilat u nda një buxhet prej 41,375 euro, dhe me kalimin e viteve, numri i pozitave dhe buxheti shkoi duke u rritur, ku deri në vitin 2014, ky fond kishte 222 persona që përfitonin prej tij dhe buxheti në dispozicion kishte kapur vlerën prej një milion eurove.¹¹

Funksionimi i "Fondit për Kuadro" bazohej në rregulloren nr. 14/2012 të Qeverisë së Kosovës, e cila specifikonte qëllimet e fondit, fushat me prioritet, si dhe kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve.¹²

Neni 3 i kësaj rregulloreje, definonte fushat të cilat konsideroheshin me prioritet për qeverinë për të cilat mund të kërkohej mbështetja e "Fondit për Kuadro". Këto fusha përfshinin:

- zhvillimin e politikave dhe legjisllacionit në fushat kryesore të përcaktuara me kriteret e Qeverisë;
- përmbushjen e kërkesave që lidhen me raportet e Kosovës dhe organizatave apo institucioneve ndërkombëtare, me theks të veçantë të organizatat financiare ndërkombëtare; si dhe
- fushat që merren me integrimet evropiane dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare.

⁹ Qeveria e Kosovës (2008), Vendimi 02/48. Burimi: <https://bit.ly/3LwKU0g>

¹⁰ Instituti GAP (2015), Fondi për Kuadro, Program financimi për pozita deficitare apo menaxheriale? Burimi: <https://bit.ly/3wEFLD>

¹¹ Ibid.

¹² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2012), Rregullore nr. 14/2012 për funksionimin e fondit për kuadro. Burimi: <https://bit.ly/3LmQLF6>

Për më shumë, në këtë rregullore definoreshin në detaje edhe kriteret për përcaktimin e pozitave dhe përzgjedhjen e kandidatëve përfitues të këtij fondi. Disa nga kriteret e kërkuara ishin: kualifikime dhe shkathësi të avancuara profesionale, përvojë në fushat kryesore të dikastereve të qeverisë, përvojë edhe nga sektori privat dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe përvojë nga fushat përkatëse.¹³

Struktura drejtuese e "Fondit për Kuadro" përbëhej nga Komisioni i Fondit për Kuadro (KFK) dhe Njësia e Fondit për Kuadro (NJFK), në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Sipas rregullores për funksionimin e këtij fondi, përgjegjësitë kyçe të Komisionit të Fondit ishin: shqyrtimi dhe aprovimi i pozitave të propozuara nga ministritë, mbikëqyrja e arritjes së objektivave të përgjithshme të fondit dhe implementimit me efikasitet, raportimi lidhur me funksionimin dhe rezultatet, si dhe rekomandimi për ndarjet buxhetore të fondit ndaj qeverisë.¹⁴

Ndërsa, detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë së Fondit për Kuadro sipas rregullores të përmendur më lartë, ishin: ofrimi i asistencës dhe bashkëpunimi me ministritë lidhur me funksionimin e fondit dhe përgatitjen e dokumentacionit, monitorimi i zbatimit të procedurave, ofrimi i asistencës për Komisionin (KFK) lidhur me të gjithë procesin, si dhe çështje tjera koordinuese në mes të institucioneve. Organi kryesor vendimmarrës i këtij fondi për miratimin apo mosmiratimin e pozitave ishte Paneli Vlerësues Qendror i cili përbëhej nga sekretarët e përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit (ZKM), Ministrisë së Administratës Publike, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Integriteteve Evropiane, si dhe sekretari i përgjithshëm i ministrisë kërkuese për pozitën. Ky panel, pas pranimit të dokumentacionit për pozitën dhe kandidatët e përzgjedhur nga ZKM dhe ministritë e linjës, rekomandonte tek KFK miratimin e pozitave të caktuara, dhe KFK përfundimisht merrte vendimin për pozitën dhe kandidatët e përzgjedhur.¹⁵

Megjithatë, përkundër këtyre kriterëve të përzgjedhjes dhe qëllimeve të definuara qartë me rregulloren nr.14/2012, Instituti GAP i cili ka monitoruar këtë fond që nga themelimi i tij, në vitin 2015 erdhi në përfundim se fondi është keqkuptuar dhe keqpërdorur nga ministritë e ndryshme.¹⁶ Të gjeturat e Institutit GAP tregojnë se shumica e përfituesve nuk i përmbushin kriteret, disa madje nuk kishin as shkollim të avancuar universitar, ku nga 222 zyrtarë që ishin përfitues të fondit gjatë vitit 2014, vetëm gjashtë prej tyre ishin me titullin doktor shkence, 94 ishin me titull master dhe për 54% të përfituesve, përkatësisht 122 persona nuk dihej nëse kanë të paktën diplomë universitare.

Në anën tjetër, shumica e përfituesve ishin shërbyes civilë dhe ishin futur në kategorinë e përfituesve, duke krijuar kështu një praktikë të keqe të ministrive të cilat fondin e kishin shndërruar në një lloj shtese për të shpërblyer disa punonjës. Për më tepër, shumica e përfituesve ishin njerëzit që udhëhiqnin me pozitën menaxheriale si: drejtorët, zëvendësdrejtorët, si dhe udhëheqësit e divizioneve brenda ministrive, të cilët nuk paraqitnin pozitë deficitare në tregun e Kosovës. Këto abuzime dhe shkeljet e tjera, bënë që ky fond të pezullohet përkohësisht në vitin 2015 dhe që nga ajo kohë nuk është riaktivizuar më.

Nëse krahasohet "Fondi për Kuadro" i viteve 2009–2015, dhe "Fondi i Ekselencës" i propozuar rishtazi nga qeveria (bazuar në informatat e publikuara deri tani), vërehet se ka një dallim në konceptin bazë të këtij fondi. Edhe pse qëllimi është i njëjtë: plotësimi i kapaciteteve të kufizuara të shërbyesve civilë me profesionistë në fusha të ndryshme, dallon qasja në adresimin e kësaj sfide. Në rastin e "Fondit për Kuadro", profesionistët angazhoheshin si pjesë e stafit civil të institucioneve, ndërsa

¹³ Ibid.

¹⁴ Ibid

¹⁵ Ibid

¹⁶ Instituti GAP (2015), Fondi për Kuadro, Program financimi për pozitë deficitare apo menaxheriale?

Burimi: <https://bit.ly/3wEFGLD>

kompensoheshin sipas skemës së këtij fondi. Ndërsa, tek "Fondi për Ekselencë", siç është paraqitur në vendimin e qeverisë, profesionistët/ekspertët pritet të angazhohen për një kohë të caktuar, në një agazhim të caktuar (hartim i projekteve, strategjive, legjisllacionit, e të tjera).

Nëse analizohen për një periudhë më afatgjatë, angazhimi i profesionistëve si pjesë e shërbimit civil mund të ketë ndikim më të madh, meqenëse ndikon drejtpërdrejtë në reformimin e administratës publike, si dhe caktimit të profesionistëve të fushave relevante, në pozita udhëheqëse nëpër institucione. Për më shumë, përmes kompensimit më të lartë krahasuar me pagat ekzistuese, ndikon në motivimin e këtyre profesionistëve dhe qëndrimin për një periudhë më të gjatë në shërbimin civil.

Praktikat e ngjashme në vendet tjera

Ngjashëm me Kosovën, sektori publik në shumë vende përballlet me sfida të ndryshme për t'iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave të shoqërisë. Për shkak të këtyre sfidave të vazhdueshme, ky sektor është subjekt i reformave të mëdha. Nevoja për reforma shfaqet veçanërisht në kohë krizash financiare ku fokusi dhe e ardhmja e vendit është e varur në efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimeve publike. Prandaj, për të përmirësuar efikasitetin e administratës publike, Rrjeti i Administratës Publike Evropiane (European Public Administration Network, EUPAN) në vitin 2000 prezantoi Kornizën e Përbashkët të Vlerësimit (Common Assessment Framework, CAF) që kishte si synim menaxhimin e cilësisë totale (Total Quality Management, TQM) të sektorit publik.¹⁷ Korniza CAF është rezultat i një bashkëpunimi intenziv mes shumë profesionistëve dhe akterëve në skenën evropiane për më shumë se 12 vjet. Secila presidencë evropiane, gjatë mandatit të saj ishte e fokusuar në përmirësimin, zhvillimin dhe përhapjen e mëtejshme të këtij modeli, në mënyrë që të krijohet një kulturë e menaxhimit të cilësisë në sektorin publik kudo nëpër Evropë.¹⁸ CAF është një kornizë e lehtë për t'u përdorur që mund të ndihmojë administratat publike në të gjithë BE-në të kuptojnë dhe përdorin teknikat moderne të menaxhimit dhe ka këto synime kryesore:

- futjen e administratave publike në kulturën e ekselencës dhe parimeve të TQM (menaxhimit të cilësisë totale);
- udhëzimin e administratave në mënyrë progresive në një cikël të plotë PDCA (Planifiko, Bëj, Kontrolllo, Vepra);
- të ndihmojë vetëvlerësimin e një organizate publike, në mënyrë që të arrihen veprime përmirësuese;
- të veprojë si një urë lidhëse për modelet e ndryshme të përdorura në menaxhimin e cilësisë; si dhe
- të lehtësojë të mësuarit në grup ndërmjet organizatave të sektorit publik.¹⁹

Një vend në zhvillim i cili ka praktikuar një skemë të ngjashme për angazhim të ekspertëve në sektorin publik është Mauritiusi. Kjo skemë, e quajtur "Expert Skills Scheme," ka për qëllim të bëjë angazhimin e ekspertëve në disa fusha të caktuara në sektorin publik për të plotësuar kapacitetet njerëzore të insitucioneve publike. Më konkretisht, ekspertët angazhohen për hartimin dhe implementimin e projekteve qeveritare, politikave publike dhe skemave të ndryshme. Angazhimi i tyre bëhet përmes procedurave të prokurimit publik, si shërbime konsulence, dhe jo përmes rekrutimit të rregullt. Procesi i prokurimit fillimisht fillon me identifikimin e aftësive/

¹⁷ European Public Administration Network (2010), Growing Towards Excellence in the European Public Sector, A decade of European collaboration with CAF. Burimi: <https://bit.ly/37GMnCq>

¹⁸ Ibid.

¹⁹ European Public Administration Network (2020), CAF Common Assessment Framework. Burimi: <https://bit.ly/3Edv1sX>

pozitive të kërkuara nga ministritë përkatëse dhe më pas përgatitjen e Termave të Referencës për angazhimin, shpenzimet dhe metodën e preferuar të prokurimit. Këto dokumente dërgohen më pas tek Ministria e Financave për aprovim të buxhetit, dhe bëhet hapja e procesit të aplikimit. Procesi i prokurimit mund të bëhet në tre mënyra: tender i hapur (përmes thirrjeve publike), përzgjedhje nga lista e ngushtë (ministria përkatëse identifikon ofrues të shërbimeve bazuar në njohuritë paraprake nga burimet zyrtare dhe përgatit një listë të shkurtë), apo prokurim i drejtpërdrejtë (përmes negociatave të drejtpërdrejta, mirëpo vetëm në disa raste të caktuara).²⁰

Përveç praktikave të përmendura më lartë, edhe disa nga vendet rajonale aplikojnë fonde të ekselencës për të përmirësuar efikasitetin e sektorit publik. Për shembull, Shqipëria ofron mbështetje financiare për vazhdimin/përfundimin e studimeve të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë përmes përdorimit të të hyrave nga buxheti i shtetit, donacioneve apo formave tjera të të hyrave.²¹ Një nga kriteret për të përfituar mbështetje financiare sipas pikës 2 të këtij vendimi është edhe pranimi që të punojnë në institucionet e administratës shtetërore apo institucionet e pavarura publike në Shqipëri, për së paku dy vjet, pas përfundimit të studimeve dhe diplomimit në ciklin përkatës të studimeve, për të cilin studentët kanë përfituar bursën.²² Përfituesit e "Fondit të Ekselencës" janë të punësuar nga dhjetë departamente përkatëse të administratës publike, për punësimin e përkohshëm të studentëve të "Fondit të Ekselencës" në institucionet e administratës publike në raport me kohëzgjatjen e detyrimit kontraktor ("Fondi i Ekselencës" u shua gjatë vitit 2022).²³

Përveç "Fondit të Ekselencës", Shqipëria ka edhe programe të tjera përmes së cilave synon angazhimin e praktikantëve në sektorin publik si p.sh.: "Programi Kombëtar i Praktikës së Punës në Administratën Publike". Ky program synon të përfshijë pjesëmarrësit në një eksperiencë pune të integruar, në bashkëpunim me profesionistë të karrierës në administratë publike, në mënyrë që këta pjesëmarrës të përfitojnë nga ekspertiza që e cila në të ardhmen do të ndikojë në zhvillimin e aftësive profesionale të tyre, si dhe njohjen me mënyrën se si funksionon administrata publike.²⁴

Përfundime dhe rekomandime

Qeveria e Kosovës, përmes një vendimi, në fillim të vitit 2022, themeloi "Njësinë për Ekspertizë" përmes së cilës do të bëhet angazhimi i ekspertëve vendor dhe të huaj në sektorin publik, me qëllim që të ofrohet ekspertizë në fusha të caktuara ku ka mungesë të kapaciteteve njerëzore dhe të ofrohen shërbime në përmirësimin e hartimit dhe zbatimit të politikave, planifikimit dhe zbatimit të projekteve si dhe në rolin këshillëdhënës ndaj qeverisë. Megjithatë, ndonëse për këtë njësi janë ndarë mjete buxhetore për fillimin e operimit të saj, ky proces është ende në fazë fillestare të implementimit dhe nevojiten fonde shtesë për implementimin e plotë të tij.

Duke u mbështetur në përmbajtjen e vendimit të qeverisë, mund të thuhet se funksioni dhe ideja e kësaj njësie për ekspertizë është e ngjashme me skemën "Fondi për Kuadro" e realizuar në periudhën 2009–2015 nga Qeveria e Kosovës. Duke marrë parasysh ngjashmëritë dhe sfidat e krijuara nga skema e mëparshme, e që ndikuan edhe në përfundimin e operimit të kësaj skeme në vitin 2015, qeveria duhet të konsiderojë edhe mundësitë për keqpërdorimin e fondit në favor të interesave personale apo politike, si dhe të marrë masa për parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme.

20 Ministry of Finance and Economic Development (2017), Expert Skills Scheme. Burimi: <https://bit.ly/3EDR8Jj>

21 Qeveria e Republikës së Shqipërisë (2020), Vendim Nr. 160, për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civil. Burimi: <https://bit.ly/3vahrm6>


22 Ibid.

23 United Nations (2021), Voluntary Review Report on the Status of Implementation of the Global Compact for Migration in Albania in 2021. Burimi: <https://bit.ly/3JDbCTv>

24 Ibid.

Në mënyrë që të parandalohen praktikat e mëparshme të keqpërdorimeve të fondit, Instituti GAP ka disa rekomandime:

- Të definohen qartë nevojat e institucioneve dhe fushat/pozitat për të cilat do të nevojitet angazhimi i ekspertëve. Lidhur me këtë, të themelohen prapë organet vendimmarrëse për këtë (sikurse në rastin e "Fondit për Kuadro") si për shembull Komisioni i Fondit të Ekselencës, i cili përbëhet nga përfaqësues të lartë të zyrës së Kryeministrit dhe disa ministrive relevante. Për më shumë, të definohet se cila do të jetë forma e angazhimit të ekspertëve dhe për sa kohë do të angazhohen, si për shembull a do të angazhohen ekspertët individualisht, apo do të angazhohen kompani të cilat ofrojnë shërbime të konsulencës;
- Të bëhet një specifikim i qartë i kriterëve të përzgjedhjes së kandidatëve, si dhe respektimi i atyre kriterëve në momentin e përzgjedhjes, pasi që në rastin e mëparshëm të "Fondit të Kuadrove" janë përzgjedhur kandidatë të cilët nuk i kanë plotësuar as kriteret bazë për të qenë pjesë e ekspertizës. Për më shumë, duhet të evitohen në çdo rast keqpërdorimet e fondit për arsye të nepotizmit;
- Të përkrahen kuadrot deficitare që janë aktualisht pjesë e institucioneve si incentivë që të qëndrojnë në shërbimin civil për një periudhë më afatgjatë;
- Marrë parasysh që ndarja buxhetore në vlerë prej një milion euro konsiderohet e ulët për të realizuar angazhimin e ekspertëve të nivelit të lartë dhe 45,000 ditët e planifikuara, do duhej që së paku 25% e financimit të këtij fondi të mbulohet me buxhet shtetëror, deri në 5-6 milionë euro, dhe pjesa tjetër të mbulohet nga donatorët/organizatat ndërkombëtare;
- Një tjetër rekomandim është qeveria përveç angazhimit të ekspertëve nga jashtë, të mundohet të përfshijë edhe profesionistë vendor të cilët përfitojnë bursa nga skema studimi për studime jashtë vendit, të financuara nga vetë qeveria, apo organizatat ndërkombëtare me qëllim të kontributit në Kosovë. Për shembull, sikur në rastin e bursës Young Cell Scheme, ku bursistëve ju mbulohen të gjitha shpenzimet e studimeve Master, me kusht që pas përfundimit të studimeve të kthehen në Kosovë dhe të punojnë për institucione publike për një periudhë tri vjeçare. Një proces i ngjashëm do të mund të realizohej edhe me skemat e tjera të bursave si: USAID Transformational Leadership Program, KAEF Graduate Fellowship Program, Fulbright Program, DAAD, Swedish Institute Scholarship Program, e të tjera. Përfshirja e këtyre profesionistëve në fondin e ekselencës do të mund të bëhej pas periudhës tri vjeçare të përfundimit të obligimit kontraktual si pjesë e shërbimit civil të rregullt, në mënyrë që të stimulohen të vazhdojnë kontributin në shërbimin civil edhe më tej.





Funded by
the European Union

Projekti "Inovacioni për mediat e
qëndrueshme dhe angazhimin qytetar"
i financuar nga BE, implementohet nga:

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 


KOSOVO 2.0

**Themelimi i Njesisë për Ekspertizë:
mësimet nga e kaluara për një fond
par excellence**